



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**INSTITUTI I SIGURIMEVE SHOQËRORE
DREJTORIA E MARRËDHËNIEVE ME PUBLIKUN
SEKTORI I PROCEDURAVE ADMINISTRATIVE, LETRAVE DHE
PLATFORMËS SË BASHKËQEVERISJES**

Nr. 9315/1prot.

Tiranë, më 23.09.2024

Lënda: Kthim përgjigje

Z. Ferit Ajazi

Adresa: Lagjja nr.1, Bathore – Kamëz.

Tel: 068 34 477 36

Në përgjigje të kërkesës tuaj, drejtuar Institutit të Sigurimeve Shoqërore, të regjistruar me nr. 9315 prot, datë 11.09.2024, ju informojmë se:

Referuar dokumentacionit që administrohet në dosjen tuaj të përfitimit, rezulton se Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Tiranë, me vendim caktim pensioni nr.1891, datë 26.11.2001, ju ka caktuar pension pleqërie kategoria e III (minimal i kohës), me masë fillestare pensioni 5,148 lekë në muaj, me 33 vite e 7 muaj periudhë sigurimi, me datë fillimi pensioni 06.10.2000.

Nga auditimi i hedhjes së të dhënave në regjistrin elektronik të përfitimeve, rezultoi se ky përfitim është regjistruar me NID F50105195M dhe i datëlindjes 05.01.1955, ndërsa përfitimi është caktuar me datëlindje 06.10.1940 sipas certifikatës së ZGJC nr.4, datë 20.09.2001. Duke qenë i datëlindjes 05.01.1955, nuk plotësonit moshën e kërkuar, për të përfituar pension pleqërie kategoria e III, sipas nenit 92, të ligjit 7703, datë 11.05.1993 "Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.

Pensioni i pleqërisë është pezulluar dhe jeni shpallur debitor në shumën 797.026 lekë, për periudhën e përfitimit 06.10.2000 - 31.12.2008.

Me kërkesë nr.1167, datë 31.12.2019 keni aplikuar sërish për pension pleqërie, bazuar në nenin 32, 92 të ligjit 7703, datë 11.05.1993 "Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar.

Me vendim caktim pensioni nr.1891/1, datë 06.02.2020, Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Tiranë, ju ka caktuar pension pleqërie kategoria e III, me 32 vite periudhë sigurimi, me datë fillimi pensioni 05.01.2020, me masë fillestare pensioni 13,569 lekë në muaj.

Me ricaktimin e pensionit të pleqërisë ka filluar të mbahet nga pensioni mujor shuma debitore 797.026 lekë, për periudhën 01.02.2020 – 30.10.2029 sipas nenit 62, të ligjit 7703, datë 11.05.1993 "Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, në të cilin përcaktohet se: *personi që ka përfituar pension ose të ardhura të tjera nga sigurimet shoqërore në mënyra e mjete në kundërshtim me ligjin, detyrohet ta kthejë të gjithë shumën e marrë tepër, duke iu mbajtur çdo muaj 50% e kështit mujor të përfitimit.*

Mbi këtë masë pensioni janë zbatuar të gjitha rritjet, sipas VKM - ve "Për rritjen indeksimin e pensioneve në vite" dhe aktualisht masa e pensionit është 16,952 lekë në muaj, ndërsa të ardhurat mujore në pension janë 11, 456 lekë në muaj (*16,952 lekë masa e pensionit + 648 lekë kompensim energjie sipas VKM nr.8/2015 + 640 lekë kompensim energjie sipas VKM nr.565/2006 - 6,784 lekë ndalesa debitore = 11, 456 lekë në muaj*).

Përsa i përket informacionit që kërkoni në lidhje me rritjen e pensioneve, ju sqarojmë se, me vendim të Këshillit të Ministrave pensionet indeksohen çdo vit, për të kompensuar rritjen e çmimit të mallrave dhe të shërbimeve, në raport me rritjen e inflacionit.

Edhe për vitin 2024, Këshilli i Ministrave, me vendim nr. 582, datë 18.09.2024 miratoi indeksimin me 4.1%, për të gjitha kategoritë e pensioneve duke filluar nga data 1.10.2024.

Instituti i Sigurimeve Shoqërore si një institucion ligjzbatues, ka për detyrë zbatimin me prioritet të Vendimeve të Këshillit të Ministrave për rritjen e masës së pensionit për të gjitha kategoritë e pensioneve.

Ju faleminderit për mirëkuptimin.